

Udhëzimet për Kërkesën për Normën e Bazuar në Javët e Punësimit

E drejta juaj për përfitime dhe norma e përfitimeve javore janë përcaktuar në bazë të një formule që përdor të ardhurat e tremujorit apo tremujorëve tuaj të lartë në periudhën tuaj bazë. Në varësi të historikut tuaj të punësimit, mund të kualifikoheni për një përfitim javor më të lartë bazuar në një gjysmë të pagës tuaj mesatare javore. Për të kërkuar një rishikim të normës së përfitimit tuaj javor, duhet të përmbushni:

- Kërkesa juaj duhet të merret brenda dhjetë ditëve kalendarike nga data e fundit e Përcaktimit tuaj të Përfitimit Monetar.
- Krijimi i periudhës tuaj bazë është përcaktuar.
- Duhet të keni të paktën 20 javë i punësuar në periudhën tuaj bazë. Një javë pune përcaktohet si periudhë nga e Hëna në të Diel gjatë së cilës ju është paguar shpërblimi për punësim për një punëdhënës që vepron sipas Ligjit të Sigurimit të Papunësisë në Nju Jork.
- Duhet të siguron provën të të gjitha javëve tuaja të bazës së punësimit dhe pagave. Prova e pranueshme përfshin faturat e pagave (ose çeqeve), e zarfeve të pagave, ose çeqe të anuluar. Prova juaj duhet të tregojë emrin e punëdhënësit, periudhën/datën e pagesës, pagat dhe emrin tuaj dhe/ose numrin tuaj të Sigurisë Sociale. Në asnjë rast niveli i përfitimit i llogaritur në bazë të provës suaj të pranueshme nuk mund të jetë më shumë se norma maksimale e përfitimit që aktualisht është në fuqi.
- Norma e përfitimit të bazuar në një gjysmë page mesatare javore duhet të jetë të paktën **\$5.00** më shumë sesa shuma e përfitimeve javore bazuar në formulën e të ardhurave tremujore siç është treguar në formularin tuaj të fundit të Përcaktimit të Përfitimit Monetar.

Kërkesa për Normën e Bazuar në Javët e Punësimit është e ndarë nga një Kërkesë për Rishqyrtim. Kërkesa për Rishqyrtim diskutohet në Seksionin 4 të manualit të paraqitësit të kërkesës: "Sa përfitime do të marr çdo javë?" Një kërkesë për Normën e Bazuar në Javët e Punësimit nuk mund të bëhet deri sa të finalizoni periudhën bazë që do të përdorni dhe përcaktimi ose çdo Kërkesë Rishqyrtimi të jetë lëshuar.

Në anën e kundërt është një shembull i një formulari të plotësuar të Kërkesës për Normën e Bazuar në Javët e Punësimit. Shembulli supozon një kërkesë për përfitim në tremujorin e 4 të 2017 dhe pagat e punonjësve të raportuara në sistemin e Raportimit të Pagave në Shtetin e Nju Jorkut brenda periudhës bazë 1 Korrik 2016 deri në 30 Qershor 2017.

Punëdhënësi	Pagat				Periudha Bazë
	2/2017	1/2017	4/2016	3/2016	
Kompani Ndërtimi e Mirë, Inc. (Good Construction, Inc.)	\$5,000	\$6,594	\$7,812	\$1,375	\$20,781
Kompani më e Mirë Ndërtimi, Inc. (Better Construction, Inc.)	\$640				\$640
Kompania më e Mirë e Ndërtimit, Inc. (Best Construction, Inc.)				\$6,440	\$6,440
Totali	\$5,640	\$6,594	\$7,812	\$7,815	\$27,861

Norma e bazuar në një të njëzet e gjashtë (1/26) të pagave të tremujorit të lartë është \$300. Për ata me pagë \$3,575 ose më të ulët në tremujorin e lartë, norma e përfitimit javor bazohet në një të njëzet e pestën (1/25).

Norma e bazuar në të dhënat e punësimit dhe pagave javore sic dëshmohet nga prova e pranueshme është \$309. (Shih llogaritjet në faqen 2 të udhëzimeve.)

SHËNIM: Nëse keni punuar për më shumë se një punëdhënës në të njëjtën javë për një ose më shumë javë, si fillim duhet të plotësoni Pjesën 2 mbrapa formularit të Kërkesës për Normën e Bazuar në Javët e Punësimit. Në shembullin e mëposhtëm, javët totale në rreshtin **F** janë më pak se shuma e javëve që tregohen në rreshtin **E** për shkak të punësimit të shumëfishtë në periudhën bazë.

Shembull - Kërkesa për Normën e Bazuar në Javët e Punësimit

A. Emri dhe Adresa e Punëdhënësit	B. Kohëzgjatja e periudhës së pagesës; p.sh. javore, dy javore, etj.	C. Javët Totale të Paguara Gjatë Periudhës Bazë	D. Javët Totale të Paguara Gjatë Periudhës Bazë
1. Kompani Ndërtimi e Mirë, Inc. (Good Construction, Inc.) Anytown, NY 10101	Dy javore	43	\$ 20,781
2. Kompani më e Mirë Ndërtimi, Inc. (Better Construction, Inc.) Anytown, NY 10101	Dy javore	2	\$ 640
3. Kompania më e Mirë e Ndërtimit, Inc. (Best Construction, Inc.) Anytown, NY 10101	Javore	8	\$ 6,440
4.			
5.			
6.			
7.			
E. Javët dhe pagat totale të punës gjatë periudhës bazë		53	\$ 27.861
F. Javët totale të punës nga Pjesa 2		45	

G. Shembull i Formulës së Rillogaritjes

- Pjesëtoni pagat totale me javët totale (më e vogla e rreshtit **E** ose **F**) për të llogaritur pagën mesatare javore \$ 619.13
- Pjesëtoni pagën mesatare javore me 2 për të përfituar normën tuaj të propozuar në bazë të javëve dhe pagave. Norma nuk mund të tejkalojë \$504..... \$ 309.57
- Shkruani normën tuaj aktuale të përfitimit nga Përfitimi juaj i fundit T402 Forma e përcaktimit..... \$ 300.00
- Zbrit rreshtin 3 nga rreshti 2. Shuma **duhet** të jetë \$5 ose më shumë për të marrë normën e rillogaritur në bazë të javëve dhe pagave.....\$ 9.57

Shembull

1 2 3 4 5 6 7 8 9 * 40 41 42 43 44 45 46 47 48 49 50 51 52

Javët → Punëdhënësi ↓	7/03/16	7/10/16	7/17/16	7/24/16	7/31/16	8/07/16	8/14/16	8/21/16	8/28/16		4/02/17	4/09/17	4/16/17	4/23/17	4/30/17	5/07/17	5/14/17	5/21/17	5/28/17	6/04/17	6/11/17	6/18/17	6/25/17
A				✓	✓	✓	✓	✓	✓		✓	✓	✓	✓			✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
B																				✓	✓		
C	✓	✓		✓	✓	✓	✓	✓	✓														
Etj.																							

X

X X

Çelësi:	
X	= Nuk ka punë në dispozicion
*	= Javët 10-39; formular 26 javë për "A"

Javët Bruto	53
Javët konkurrenente	8
Javët Neto	45